



Qendra për Politika dhe Avokim Center for Policies and Advocacy

Projekti: “Për një mjedis të pastër”

Komuna: PEJË

Periudha: Shtator-Dhjetor, 2009



Botues:



Qendra për Politika dhe Avokim
Center for Policies and Advocacy

Hartues të Raportit:

Tafë Veselaj dhe Aferdita Maliqi

Hulumtues në terren:

Milaim Morina
Drilon Dobruna
Valentina Hyseni
Albulena Berisha

Redaktore:

Shqipe Pantina

Mbështetur nga:



"Ky projekt u financua përmes grantit të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve".

I. Hyrje

Mjedisi dhe mbrojtja e tij janë ndër çështjet më shqetësuese, por edhe më prioritetet, të politikbërësve në të gjithë botën, ndërkohë që posaçërisht ngrohja globale po bëhet një shqetësim serioz për globin tokësor.

Në Kosovë, çështja e mjedisit, për fat të keq, nuk ka qenë për një kohë të gjatë në listën e prioritetëve të politikbërësve. Edhe sot, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politikbërësve qoftë në nivelin qendror, por veçanërisht në nivelin lokal.


Organizata Joqeveritare Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), në raportin e saj për Komunën e Mitrovicës, pas hulumtimit që ka bërë, gjetjeve dhe debatit me përfaqësuesit e partive politike, gjatë fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009, prezanton një përmbledhje të shkurtër për gjendjen e mjedisit në këtë komunë, infrastrukturën ligjore që rregullon fushën e mjedisit, qasjen e partive politike për çështjet mjedisore dhe në fund rekomandimet që janë dalë nga tryeza e organizuar për mjedisin, e që kanë synim përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Raporti është pjesë e projektit “Për një mjedis të pastër”, i cili është mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, të cilën e falënderojmë për zemërsisht. Po ashtu, QPA falënderon thellësisht përfaqësuesit e partive politike të Komunës së Pejës, si dhe qytetarët, të cilët kanë kontribuar me komentet dhe rekomandimet e tyre.

Veçanërisht falënderojmë përfaqësuesit e partive politike, si Abedin Aliaj kandidat për Asamble komune nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, Afrim Selimaj kandidat për Asamble nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Burim Basha kandidat për Asamble Komunale nga Aleanca Kosova e Re, të cilët kanë prezantuar prioritetet që partitë parashohin në fushën e ambientit nëse fitojnë zgjedhjet lokale.

QPA po ashtu thellësisht falënderon ata që bënë të mundur jo vetëm hartimin e këtij raporti, por edhe gjithë zbatimin e projekti “Për një mjedis të pastër”: Menaxheren e Projektit, Afërdita Maliqi, ekspertin për çështje mjedisore, Tafë Veselaj, si dhe hulumtuesit Drilon Dobruna, Milaim Morina, Valentina Hyseni dhe Albulena Berisha.

II. Komuna e Pejës - karakteristikat dhe veçoritë



Komuna e Pejës shtrihet në skajin veri-perëndimor të luginës së pëlleshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske, nën shpatet e Alpeve shqiptare (Albanian Alps). Peja, së bashku me tërë Rrafshin e Dukagjinit, shtrihet ndërmjet gjerësisë veriore gjeografike 45-50 shkallë dhe 42-53 shkallë dhe gjatësisë gjeografike lindore 19 shkallë, 58’ 30’ gjer më 21 shkallë.

Qyteti i Pejës është i vendosur në teracën neogjene aluviale në lartësi mbidetare 505-520m. Peja në pikëpamje gjeomorfologjike përbën një tërësi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë¹.

¹ www.peja-komuna.org

Dendësia e popullsisë është e madhe me rreth 300 banorë në 1 (një) km². Peja është qendër e një rajoni të gjerë me afro 1.500 km², kurse Peja me fshatrat e saja ka 603 km². Brenda kufijve administrativ të Komunës së Pejës ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale.

Komuna e Pejës kufizohet me: Istogun, Klinën dhe Deçanin, kurse me Komunën e Plavës, Beranës dhe Rozhajës kufizohet me Malin e Zi². Peja ka afro 125.752 banorë, ndërkaq në dekadën e fundit ka një koncentrim të madh të popullatës në qytet, për shkak të kushteve më të mira.³

II.1. Gjendja aktuale e mjedisit

Situata e tanishme mjedisore në Pejë është e prekur jo vetëm nga potenciali ekonomik industrial i kaluar e ekzistues, por edhe nga rindërtimi i shpejtë dhe ringjallja e ekonomisë pas luftës. Mungesa e mbrojtjes së ambientit gjatë shumë viteve, si dhe lufta në Kosovë, kanë lënë pasojat edhe në Komunën e Pejës.

Problemet e evidentuara janë: ndotja nga shkarkimi i ujërave të zeza, hedhja e mbeturinave në lumenj, shfrytëzimi i rërës dhe zhavorit, mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, shkatërrimi i pyjeve në Rugovë, mungesa e rimbjelljes së drunjve, rritja e numrit të automjeteve dhe ndotja me mbeturina urbane.

Proceset e shumta ekonomike si dhe rritja urbane në Komunën e Pejës ka bartur pasoja të shumta edhe për mjedis. Pothuaj se të gjitha fushat mjedisore janë atakuar direkt apo indirekt nga të gjitha këto elemente zhvillimore.

Uji i pijes: Për shkak të pozitës gjeografike, Peja ka burime me ujë të mjaftueshëm. Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga dy burime; nga burimi i Drinit të Zi me 500l/s dhe i Drinit të Bardhë në Radavc me 500l/s. Mirëpo, rrjeti i ujësjellësit është mjaft i vjetërsuar dhe humbjet në rrjetin e ujësjellësit të qytetit janë shumë të mëdha⁴.

Gjendja e furnizimit me ujë të pijshëm në pjesët rurale është shumë e keqe. Kemi sisteme të instaluar të ujësjellësve, por popullata rurale kryesisht përdorë ujin e puseve të cekta dhe të pambrojtura. Vetëm 18 fshatra apo 10% janë të kyçura në rrjetin e ujësjellësit.

Në qytet rreth 60 % është e kyçur në kanalizim, ndërsa në fshatra rreth 10 %. Të gjitha zonat e sipërme të qytetit nuk kanë kanalizim. Nuk ka asnjë implant për pastrimin e ujërave

² Po aty

³ www.institutigap.org, Peja –Raporti Komunal

⁴ *Plani zhvillimor komunal i Pejës 2006 -2025*

të ndotura për qytet dhe fshatra dhe për momentin të gjitha ujërat fekale derdhen në Lumëbardh.

Mbeturinat: Komuna e Pejës është duke u ballafaquar me problematikën e menaxhimit të mbeturinave. Nuk është bërë mjaft për organizimin e mbledhjes së mbeturinave dhe transportit të tyre. Në zonat rurale ka fare pak organizim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave.

Po ashtu, ambienti në Pejë dhe rrethinë po degradohet përmes mijeve sipërfaqësore të tokës dhe hedhjes së të gjitha llojeve të hedhurinave në lumenj.

Në Pejë prodhohen 0.54 kg mbetura për kokë banori në ditë. Procesin e grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave deri te deponimi e bëjnë ndërmarrjet publike për shërbime komunale. Ekziston vetëm një kompani shërbyese N.P. “Higjiena Publike”, e cila mbledh, grumbullon dhe transporton mbeturinat në deponinë e qytetit në fshatin Thartin (ish-Sverkë).

Kjo kompani kontrakt punë me Komunën e Pejës për pastrimin (fshirjen dhe larjen e rrugëve) në qytet, mirëmbajtjen e parkut dhe varrezave të qytetit etj. Po ashtu, angazhohet në mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe trotuareve. Nuk ka riciklim të mbeturinave⁵.

Transporti: Kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike dhe hekurudhës. Ky i fundit është pothuajse simbolik me vijën hekurudhore në relacionin Fushë Kosovë - Pejë (81,2 km).

Ndotja e ajrit: Ndotja e ajrit shkaktohet nga komunikacioni, pjesërisht nga industria e lehtë dhe deponitë e hapura të mbeturinave komunale (me metan dhe CO₂). Aktualisht nuk ka ndonjë sistem të monitorimit të ndotjes së ajrit.

Në Pejë, në vitin 2005, janë regjistruar 30.000 automjete, pa i llogaritur automjetet e KFOR-it, UNMIK-ut, që duke harxhuar karburante lirojnë gazra që ndikojnë në rritjen e ndotjes së ajrit. Në Komunën e Pejës deri në prill të vitit 2008 janë regjistruar 4317 biznese private, ku 80 % prej tyre janë përqendruar në tregti⁶.

Bujqësia: si degë e rëndësishme e ekonomisë ka një rëndësi të madhe për Komunën e Pejës. Me bujqësi merret një numër i konsiderueshëm i popullatës (rreth 60%) dhe prej saj ajo siguron ekzistencën e vet.

⁵ Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AKMM Prishtinë

⁶ <http://www.peja-komuna.org>

Peja ka 31.252.33 ha tokë bujqësore apo 51.83%.prej kësaj nën ujitje ka 9700 hektarë. Shqetësim është humbja e tokës bujqësore. Efektet negative për mjedis që vijnë nga bujqësia janë mbetjet nga bujqësia, kontaminimi i tokës nga pesticidet dhe herbicidet, plehurat kimik dhe shumë produkte tjera kimike të dëmshme, që shfrytëzohen për këtë veprimtari.

Mbrojtja e natyrës: Bjeshkët e Nemuna janë pasuri e madhe me pyje. Sipërfaqja me pyje është rreth 25.709.72 ha (42.64% e tokës së Pejës). Një ndër problemet kyçe në pylltarinë e Komunës është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Degradimi i pyjeve po ndikon në shkatërrimin e sipërfaqeve dhe paraqitjen e erozionit.⁷

Zonat e mbrojtura të natyrës për territorin e Komunës së Pejës janë: Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, ndërsa Bjeshkët e Nemuna janë propozuara për Park Kombëtar. I tërë ky potencial i zonave të natyrës është një trashëgimi natyrore jo vetëm për Komunën e Pejës, por edhe tërë Kosovës.

Territori i Bjeshkëve të Nemuna paraqet njërin prej viseve më të rëndësishme të vlerave natyrore, i cili i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret që të mbrohet si Park Nacional. Asambleja e Komunës ka miratuar iniciativën për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna “Park kombëtar” me qëllim të mbrojtjes rigorozë të resurseve natyrore, mirëpo kjo ende nuk ka ndodhur. Territori i Bjeshkëve të Nemuna i propozuar për Park Nacional në Komunën e Pejës përfshinë 32.492.92 hektar.

Vërshimet dhe erozioni: Shtrati i Lumëbardhit është mjaft i dëmtuar si pasojë e nxjerrjes së pakontrolluar të rërës dhe zhavorrit, hedhjes së mbeturinave në shtratin e lumit, uzurpimit të tokave në të dy anët e lumit për eksploitim etj. Si pasojë e veprimit mekanik dhe kimik të ujërave rrjedhës erozioni është mjaft prezent si në pjesët e rrafshëta ashtu edhe në Bjeshkët e Rugovës.

Turizmi: Peja më rrethinë është njëra ndër qendrat me mundësi më të mëdha të zhvillimit të ekonomisë turistike. Bjeshkët e Nemuna dhe numri i madh i monumenteve kulturore-historike paraqesin bukuritë natyrore atraktive, të cilat janë të rralla në Evropë dhe shumë joshëse për vizitorë.

Si vende mjaft tërheqëse për turizmin janë Gryka e Rugovës, liqet glacial në lartësitë e mëdha mbidetare të këtyre maleve⁸, burimet e shumta të ujit, Burimi i Drinit të Bardh, shpellat e shumta, Leqinati si vend për pushim dhe argëtim, Fshati turistik Bogaj, ski- lifti dhe shumë peizazhe tjera të bukura natyrore.

⁷ *Plani zhvillimor komunal i Pejës 2006 -2025*

⁸ Liqet glacial- janë ato vende me ujë, të cilat formohen gjatë shkrirjes së borës apo akullit dhe janë në lartësitë e Maleve të Rugovës mbi 1500m.

II.2. Infrastruktura ligjore në fushën e mjedisit

Kuvendi i Kosovës deri më sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe ato që ndërlidhen me ndikimet në mjedis. Pothuaj se janë mbi 32 ligje, të cilat janë të lidhura me fushat e ndryshme të mjedisit.

Ligjet më të rëndësishme për mjedisin që zbatohen në Komunën e Pejës janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji për ujërat e Kosovës
- Ligji për mbeturinat
- Ligji për vetëqeverisje lokale
- Ligji për mbrojtjen e natyrës
- Ligji për planifikimin hapësinor
- Ligji për pyjet e Kosovës
- Ligji për gjuetinë
- Ligji për peshkatari dhe akuakulturë, si dhe shume akte tjera nënligjore.

Si akt më i lart i miratuar është Statuti i Komunës së Pejës. Në bazë të nenit 11, pika 11.1 e Rregullores Nr.2007/30 për Ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Kuvendi Komunal Pejë, më 31 mars 2008, miratoi këtë Statut. Me këtë statut rregullohet organizimi i brendshëm i Komunës dhe zbatimi i përgjegjësi të këtyre institucioneve e një ndër to edhe mbrojtjes së mjedisit.

Komuna e Pejës në vitin 2006 ka miratuar edhe Planin zhvillimor komunal 2006-2025 dhe Planin zhvillimor urban 2006-2025 , ndërsa është bërë edhe Plani lokal i veprimit në mjedis.

Ndërsa, që nga viti 2005 është hartuar Rregullorja për administrimin me mbeturinat e veturave.

II.3. Institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit

Asambleja Komunale e Pejës është institucioni më i lartë. Administrata komunale është e organizuar në 13 drejtori, ku tri drejtori janë të lidhura ngushtë me problemet dhe shërbimet e mbrojtjes së mjedisit në këtë komunë: si Drejtoria e urbanizmit, kadastrit dhe mbrojtjes së ambientit, pastaj Drejtoria për punë komunale dhe shërbime publike (e cila ofron shërbime për furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale), dhe Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe hidroekonomi, që kujdeset për zbatimin e rregullatave ligjore nga bujqësia, blegtoria, pylltaria dhe hidroekonomia, si dhe Drejtoria për punë inspektuese, që bën inspektimin në fushën e mbrojtjes së ambientit.

Në Komunën e Pejës veprojnë një numër i madh i OJQ me misione të ndryshme, por nuk është i madh numri i OJQ-ve për fushën e mjedisit, megjithatë ato që veprojnë janë mjaft aktive dhe luajnë një rol me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit në këtë territor, si OJQ “Aquila”, “Era”, etj.

III. Platformat politike të partive politike për çështjen e mjedisit

Të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 nuk kanë ofruar programe politike konkrete ku i kushtohet rëndësi fushës së mjedisit, megjithatë të gjitha, në debatin e organizuar nga QPA, kanë paraqitur si objektiv të tyre përmirësimin e ambientit. (QPA ka siguruar platformat politike, ku i kushtohet rëndësi ambientit, të partive ORA, AAK - shih aneksin).

Qendra për Politika dhe Avokim, më 24 tetor, ka organizuar një debat në Pejë me përfaqësuesit e partive politike, që garojnë në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, të cilët kanë shpalosur objektivat, planet, prioritetet dhe premtimet e tyre për përmirësimin e mjedisit.

Në debatin me titull “Për një mjedis të pastër”, kanë marrë pjesë këto subjekte politike: LDD, AAK, AKR si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, që merren me çështjen ambientale, qytetarrë dhe media.

a) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në debat është përfaqësuar nga z. Afrim Selimaj, i cili ka prezantuar programin e partisë për mjedis, duke cekur prioritetet që njehërit i kanë të inkorporuara edhe në program.

Selimaj ka thënë se AAK si prioritet ka shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, eliminimin e djegies së mbeturinave, ndaljen e ndërtimeve të egra, inspektimin e qendrave të automjeteve. Edhe në Pejë çështja e mbeturinave vazhdon të ngelet një problem shumë i madh, andaj, sipas Selimajt, AAK ka si prioritet edhe forcimin e kapaciteteve për largimin e mbeturinave, si dhe riciklimin dhe ndarjen e mbeturinave, vendosjen e kontenjerëve ekologjik, edukimin mjedisor për qytetarët, rregullimin e shtretërve të lumenjve, si dhe të pengohet prerja e pyjeve etj.

b) Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) në debat është përfaqësuar nga z. Abedin Alija, i cili pasi paraqiti problemet ekzistuese mjedisore në Komunën e Pejës, tha se për të dalë nga kjo situatë jo e favorshme mjedisore, LDD do të anagzhohet për: mbrojtjen e pyjeve, mbrojtjen dhe menaxhimin e lumenjve, trajtimin e ujërave të përdorura dhe riciklimin dhe selektimin e mbeturinave.etj.

c) Aleanca Kosova e Re (AKR) është përfaqësuar nga z. Burim Basha. Z. Basha gjatë prezantimit të platformës për mjedis përmendi elementet negative që po ndikojnë në fushën

e mjedisit, ndërkaq tha se ky subjekt nuk kishte ndonjë ndryshim të prioriteteve krahas subjekteve tjera, ngase problemet mjedisore ishin të njëjta.

AKR ka hartuar Programin që Qyteti i Pejës të shpallet qytet i gjelbërt, ndërkaq Basha tha se nëse AKR do të vijë në pushtet do të angazhohet për zhvillimin e turizmit, shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, mbrojtjen e lumenjve, ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza, do të angazhohet për aplikimin e standardeve evropiane për mbrojtjen e ambientit, si dhe në eliminim e deponive të egra, monitorimin e ujërave të pijes dhe edukimin mjedisor.

Në debat ishin të pranishëm edhe përfaqësues të SHPG “Elena Gjika”, të cilët paraqiten shqetësimet e tyre rreth degradimit të mjedisit.

IV. Rekomandimet

Rekomandimet e dala nga debati “Për një mjedis të pastër”:

- Impiant për trajtimin e ujërave të përdorura
- Riciklimi dhe ndarja e mbeturinave
- Vendosja e kontenjerëve ekologjik
- Ndërtimet e reja do të kenë 20% hapësirë gjelbëruese
- Eliminimi i deponive të egra
- Monitorimin e ujërave të pijes

Të bashkangjitura:

Aneksi 1. Platformat politike

Aneksi 2. Mbulimi medial

Programi politik i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

8. Mbrojtja e ambientit dhe mbledhja e mbeturinave

Akoma mbetet shumë për tu dëshiruar kur është në pyetje ambienti. Përkundër të gjitha prioritetëve tjera AAK-mbrojtjes së ambientit i qaset me interes të veçantë ngase e konsideron që është parakusht i domosdoshëm për realizimin e synimit primar-zhvillimit ekonomik -turizmit, bujqësisë, prodhimit ekologjik.

Ndërtimi i trotuareve, ndërprerja e qarkullimit në Korzo, rregullimi i hapsirës të Tregu i Rrobave të Vjetra, mirëmbajtja e rregullt e shtratit të Lumbardhit, parqeve të qytetit, eliminimi i kontenjerëve në qytet janë disa nga veprimet e realizuara gjatë këtij gjysëm-mandati të AAK-së në drejtim të realizimit të premtimeve programore por edhe të zbatimit të strategjisë programore për një Pejë - Qytet lule e Dukagjinit

Planifikimet:

- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta –
- Përmirësimi të ndjeshëm të pastrimit dhe largjes së rrugëve.
- Eliminimi të djegies së mbeturinave në lokalitete
- Lehtësimi dhe disiplinimi të trafikut,
- Disiplinimi të aktivitetëve ndërtimorë
- Izolim i detyrueshëm i punishteve/gjopa për thyesit
- Zbatimi të politikave dhe standardeve të kontrollit të shkarkimeve të gazërave nga transporti dhe aktivitetet industriale - inspektim i qendrave të kontrollit të automjeteve, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse dhe Inspektoratet
- Ngritja, forcimi i kapaciteteve vendore për monitorimin dhe zbatimin e rregullave dhe standardeve mjedisore.
- Përmirësim në sistemin e transportit,

Mbledhja e mbeturinave:

1. Ristrukturim i formës së shërbimit të deritanishëm;
2. Forcimi i kapaciteteve monitoruese dhe zbatuese për pastrimin dhe largimin mbeturinave
3. Përgatitje e programit të detajuar afat-mesëm për përmirësim thelbësor të shërbimit (në

bashkëpunim me Qeverinë, Qytetarët dhe Shoqërinë Civile)

Zbatimi i programit afatmesëm:

1. Ndarje të mbeturinave, riciklim dhe trajtim me teknologji bashkëkohore
2. Shtrirje e shërbimit në të gjithë qytetin
3. Vendosjen e kontejnerëve ekologjik. Në ato hapsira ku nuk është e mundur të bëhet eliminimi i tyre - lagje të dendësisë së rralle dhe pamundësi qarkullimi të automjeteve për bartje
4. Sigurim i financimit afatgjatë të shërbimit nëpërmjet taksës vendore dhe partneritetit publik-privat.
5. Edukim i publikut në bashkëpunim me institucionet arsimore, universitare dhe shoqërinë civile.-OJQ mjedisore - tryeza, debate, reportazhe etj.

Programi operativ

- Të shtrohen të gjitha rrugët e qytetit me asfalt dhe kubëza;
- Të vazhdohet me projekte për modernizimin dhe zgjerimin e rrugëve kryesore të qytetit;
- Secili fshat do të ketë qasjen në rrugën e asfaltuar në qendër të fshatit, ndërsa që do të rregullojmë dhe do ti trajtojmë rregullisht edhe rrugët në Rugovë;
- Të kubëzohen të gjitha trotualet;
- Të kryhet çdo ditë pastrimi i rrugëve;
- Ndriçimi publik - Do të vendosen shtylla të reja në të gjitha hyrjet dhe daljet e Pejës, si dhe venbanimet rurale - në vitin e parë në fshatrat ku ndodhen zyrat komunale.

6.3. Ujësjellësi, Kanalizimi fekal dhe Kanalizimi atmosferik

a. Ujësjellësi

- Përkundër resurseve të konsiderueshme të ujit të pijshëm, (Peja ka dy burime të ujit për pije-ujë i Burimit të Zi me 500 l për sec. dhe ai i Drinit të Bardhe me po ashtu 500 l në sec - pra gjithsej 1000 litra në sec.) për shkak të humbjeve të mëdha në rrjet dhe në keqpërdorimin e ujit, qyteti së shpejti mund të ketë probleme me furnizim të ujit. Si rrjedhojë nevojitet hartimi i një studimi të ri për identifikimin e burimeve të furnizimit të ujit, mekanizmave për rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe ndërtimin e zgjerimin rrjetit të ri distributiv si dhe kontrollin efikas të harxhimit "në prag të konsumuesit" .
- Së bashku me donatorë gjatë qeverisjes sonë dyvjeçare kemi ndërtuar mbi 16 km ujësjellës ndërsa që tashmë kemi të nënshkruar marrëveshjen me USAID-in për bashkëfinancim të ujësjellësit për të gjitha fshatrat e Lugut të Leshanit dhe të Trestenikut.
- Hapat që do të fokusohemi në këtë sferë do të jenë:

1. Ngritja e grupit të punës -expert-

- Studimit për identifikimin e burimeve të ujit
- Studimit për mekanizmat e rehabilitimit të rrjetit egzistues
- Studimit për ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të ri distributiv
- Studimit për mundësit për kontrollin efikas të hargjimit në prag të konsumesit

2. Ndalimi i shfrytëzimit të palejuar të ujit të pijshëm

3. Fillimi i projektit të impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura për Pejën;

Ne sigurojmë 24 orë ujë dhe me cilësi sipas standardeve për të secilën familje të Komunës së Pejës dhe AAK këtë synon të realizojë në gjysmën e parë të mandatit të ri qeverisës.

Kanalizimi fekal dhe atmosferik - Gjendja ekzistuese

Ndonëse me mjetet vetaneke dhe donatorë kemi ndërtuar mbi 17 km kanalizim fekal në disa lokalitete të Komunës sonë dhe kemi përfunduar krijimin e rrjetit kryesor të kanalizimit fekal në qytet situata në këtë fushë vazhdonë të jetë jo e mirë dhe kërkon investime serioze.

Shifrat kanë treguar që në Pejë para vitit 2007 vetëm rreth 60% e popullatës ishin të kyçur në kanalizime të ujërave të zeza, ndërsa në fshatra vetëm 10%. Invetsimet në këto dy vite kanë sjellë një situatë tjetër dhe tashmë mund të konstatojmë se në qytet 80% e popullatës është e përfshirë në kanalizim fekal ndërsa që në fshatra edhe pse në disa lokalitete si Barani, Krysheci etj është ndërtuar kanalizimi fekal situata vazhdonë të jetë e keqe. Edhe në kanalizimin atmosferik janë bërë investime të rëndësishme. Kanali i hapur përgjatë rrugës Adem Jashari tashme nuk paraqet problem për vërshime ndërsa që edhe në rrugët e shumta që janë rregulluar janë trajtuar ujërat atmosferike.

Planet

- Të shpallet si prioritet Komunal hartimi i dokumentit operativ për ndërtimin e rrjetit fekal dhe atmosferik të kanalizimit të Komunës së Pejës
- Të hartohen projekt-propozimet për projektet imediate për lagjet e papërfshira të qytetit e të fshatrave dhe të hulumtohen fondet për përkrahjen e tyre- USAID-i, AER, SIDA, GTZ
- Me NK "Drini i Bardhë" të gjenden mundësitë dhe donatorët për rregullimin e përroskave
- Çokolica dhe Zarat
- Të punohet studimi dhe projekti për Impiantin e trajtimit të mbeturinave fekale dhe të hulumtohen mundësitë për financim nga fondet e BE.
- Intervenimet në rrugë të bëhen vetëm në përputhje me standardet dhe paralel me rregullimin e rrjetit përcjellës -rrjetit të kanalizimit, ujerave atmosferik ujësjellësit, PTT, KEK etj.
- Fillimi i projektit të impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura për Pejën

6.4. TERMOFIKIMI

Në periodën kur në Kosovë janë në rrjedhë e sipër proceset tranzitore dhe anëtarësimi në BE, është aktuale edhe përshtatja e normave dhe standardeve me ato të BE-së. Një prej fushave më të rëndësishme është padyshim fusha e prodhimit dhe e shfrytëzimit të energjisë. Kjo natyrisht në mënyrë më eksplicite ka të bëjë me Qytetin e Pejës. Industria e shkatërruar dhe gjendja ekzistuese pa vizion të qartë zhvillimor, në shikim të parë nuk jep shpresë të madhe për realizimin e ndonjë investimi kapital çfarë është termofikimi. Mirëpo, nëse dëshirojmë që ta shtyjme përpara zhvillimin e qytetit tonë, nëse dëshirojmë t'u sigurojmë perspektivë fëmijëve tonë, atëherë investimet në energji duhet të jenë me prioritetin më të lartë.

Në këtë kontekst, ideja e Aleancës konform standardeve evropiane, bazohet në ndërtimin e një kapaciteti të ri energjetik me ko-gjenerim - për prodhimin paralel të energjisë termike dhe elektrike me koeficient shumë të lartë të shfrytëzimit.

Me këtë zgjidhje do të mundësohej prodhimi i energjisë së nevojshme për industrinë ekzistuese- Fabrika e Birrës me avull teknologjik sipas parametrave teknike të konsumuesëve industrial, energjia termike për ngrohjen qendrore me rrjetin termofikues për qytetin e Pejës si dhe prodhimi i energjisë elektrike me parametra kompatible me rrjetin distributiv të KEK-ut. Kjo do të thotë se Sistemi i kogjenerimit do të prodhojë edhe energjinë elektrike edhe atë termike për nevojat e veta, e tepriat ose mungesat i jep ose i merr nga rrjeti.

Si të vepohet:

- Të shpallet prioritet komunal ndërtimi i një impianti të tillë të kogjenerimit me parametra të cilët do të konfirmohen me një studim përkatës
- Të hartohet studimi i furnizimit me energji termike për qytetin e Pejës me përkrahje të Industrisë ekzistuese para se ata të veprojnë në mënyrë të gabuar dhe të zgjidhin individualisht nevojën e tyre.
- Të krijohen mundësit ligjore - përmes Ligjit mbi Energji, për investimet e kapitalit vendor ose të huaj p.sh. me koncesione me modele të BE-së.

7. INSPEKTORATI

Duhet të rikujtojmë faktin se me ardhje në pushtet u gjet një Inspektorat i paorganizuar si duhet me rregull e diciplinë të pamjaftueshme në punë.

Kemi premtuar:

- Përcjelljen e sigurisë në komunikacionin rrugor
- Mbikëqyrjen e rregullësisë sanitare të artikujve ushqimor në prodhim dhe qarkullim

- Mbikëqyrjen e ujit të pijshëm
- Mbikëqyrjen e shfrytëzimit të sipërfaqeve publike
- Identifikimin e bizneseve joformale dhe legalizimin e tyre
- Pengimin e ndërtimeve pa leje
- Përcjelljen e respektimit të kushteve urbanistike për objektet me leje ndërtimi.
- Bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat e ndër-lidhura me problematiken

Realizuar:

- Rregull e diciplinë në punë
- Takime të rregullta pune (çdo mëngjes) në relacionin Drejtor - Shef - Inspektor
- Klimë të mirë të bashkëpunimit me qytetarët duke shqyrtuar profesionalisht kërkesat e tyre dhe duke përcjellë me kujdes shqetësimet e tyre
- Harmoni dhe frymë të mirë bashkëpunimi me Drejtoratet tjera
- Bashkëpunim të mirë me Inspektorate nga niveli Regjional dhe ai Republikan
- Bashkëpunim të mirë me Policinë dhe Gjykatat
- Largimin e shitësve ambulant nga shumë rrugë të qytetit
- Rregull në tregjet e qytetit
- Mbrojtjen e sipërfaqeve publike nga dëmtimet apo nga shfrytëzimi pa leje
- Mbikëqyrje maksimale të rregullësisë sanitare të artikujve ushqimor dhe ujit të pijshëm
- Identifikimin e qindra bizneseve informale të cilat pastaj u detyruan për t'u pajisur me leje pune
- Identifikuar dhjetëra ndërtime pa leje, pronarët e të cilave detyruam të pajisen me leje ndërtimi.

Planifikojmë:

- Sjelljen në nivelin ZERO të bizneseve pa leje pune dhe ndërtimeve pa leje ndërtimi
- Identifikimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, gjatë viteve të kaluara dhe legalizimin e tyre (aty ku janë në harmoni me planin urbanistik), gjegjësisht rrënimin e tyre (aty ku nuk janë në pajtueshmëri me planin urbanistik)
- Identifikimin e objekteve të vendosura apo të ndërtuara pa leje në sipërfaqet publike dhe largimin gjegjësisht rrënimin e tyre
- Identifikimin e hapsirave dhe objekteve publike të uzurpuara dhe lirimin e tyre
- Marrjen e kompetencave nga niveli qendror dhe mbrojtja maksimale të shtrateve të lumenjeve nga eksploatimi i egër i zhavorit

Programet e partive për zgjedhjet e nëntorit Pak interesim për ambientin

Pak nga partitë politike kanë konkretizim për zgjidhjen e problemeve dhe nevojave që ka Peja në këtë sektor. Të shtunën në një debat të mbajtur në Pejë ato kanë treguar se pak nga to kanë edhe gatishmëri për të diskutuar për këto çështje

Enver Ullaj

Të gjitha partitë politike në komunën e Pejës kanë në programet e tyre çështjet e ambientit, por pak nga to kanë konkretizimin për zgjidhjen e problemeve dhe nevojave që ka Peja në këtë sektor. Edhe më pak nga to kanë gatishmëri për të diskutuar për këto çështje. Qendra për Politikë dhe Avokim (QPA) është bindur për këtë të shtunën kur i kishte ftuar subjektet politike që të debatohin për këtë temë, dhe nga të gjitha subjektet janë përgjigjur vetëm tre. AAK, LDD dhe AKR kanë prezantuar programet e tyre, ndërsa subjektet tjera, përfshirë PDK, LDK dhe Orën nuk janë paraqitur fare. Shqipe Pantina nga QPA ka thënë se qëllimi i këtij debati ka qenë t'i orientojë partitë ndaj temave të përditshmërisë dhe realitetit kosovar jashtë temave të mëdha për të cilat po flasin. Megjithatë fushatat që janë shndërruar në mega koncerte si duket po tërheqin më shumë vëmendjen sesa debati mbi problemet qytetare, ka thënë ajo.

Kandidatët e pranishëm në debat në prani të mediave dhe shoqërisë civile kanë paraqitur projektet e tyre, që kryesisht kanë të bëjnë me pastërtinë e

qytetit, mbrojtjen e shtratit të Lumit të Bardhë dhe angazhim më aktiv për mbrojtjen e pyjeve. Për AAK-në, sipas kandidatit të saj Afrim Selimaj, janë hartuar projekte konkrete për rregullimin detaj urban dhe hapësiror të territorit të tërë komunës, ndërsa në projektet e AAK-së synohet zhvillimi ekonomik, duke u mbështetur në turizëm, mbrojtje të ambientit, mbrojtje të parqeve dhe zgjerim të sipërfaqeve të gjelbëruara, Lumëbardhit dhe ndërtimit të shtigjeve për këmbësorë deri në pjesët më atraktive të bjeshkëve.

Burim Basha, kryetar i degës së AKR-së, ka thënë se në rast fitoreje AKR do largojë gjithë deponitë ekzistues nga rrugët e qytetit, do shtojë sipërfaqe të gjelbëruara përreth objekteve të banimit, menaxhojë më mirë me mbeturina dhe ujëra sipërfaqësore dhe do ta bëjnë të pastër ujin e Lumëbardhit, që momentalisht është shumë i ndotur. Kurse Abedin Alia nga LDD ka thënë se kandidati i këtij subjekti për kryetar të Pejës, Elmi Berisha, ka projektin e riciklimit të mbeturinave dhe prodhimin e energjisë përmes këtij procesi. LDD po ashtu angazhohet edhe për mbrojtjen e pyjeve, pastrimin e Lumëbardhit, sistemin e ujërave të zeza, etj.

Partitë, pak INTERESIM për mjedisin

Nga 17 subjekte politike të certifikuara për zgjedhjet lokale në komunën e Pejës, vetëm tre sosh morën pjesë në debatin për mjedisin dhe planifikimin hapësinor

Pejë, 25 tetor

S hqipe Pantina, drejtoreshë e Qendrës për Politika dhe Avokim, tha se debati për mjedisin dhe planifikimin hapësinor kishte për qëllim që të njihen më për së afërmi prej subjekteve politike që garojnë për zgjedhjet e 15 nëntorit të këtij viti, se çfarë parashohin, apo cilat janë zgjedhjet që ato ju ofrojnë qytetarëve të komunës së Pejës në programet e tyre për këtë çështje me rëndësi. Mirëpo, interesimi i partive politike ishte i vogël, pasi nga 17 subjekte politike të certifikuara për zgjedhjet lokale në komunën e Pejës, vetëm tre sosh morën pjesë. Në këtë debat ishin të pranishëm përfaqësues të AAK-së, e cila është në krye të pushtetit lokal, pastaj ata të AKR-së me kryetarin e tyre dhe një përfaqësues i Forumit Rinor të LDD-së, të cilët u munduan që të përcjellin mesazhin e tyre se ata ofrojnë zgjedhje të mira dhe në interesat e qytetarëve të kësaj komune.

Afrim Selimaj, nga AAK-ja, tha se në kemi një program ku kemi të përfshirë synimet tona në këtë drejtim. Rregullimi i qendrës së qytetit, shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtja e atyre ekzistuese, riciklimi i mbeturinave, disiplinimi i ndërtimeve dhe hapja e sipërfaqeve të gjelbëruara rreth ndërtimeve të larta, mbesin edhe më tej objektiva të AAK-së. Kryetari i AKR-së, Burim Basha, u pajtua se nuk është bërë e tëra që duhet deri më tani në këtë drejtim dhe se lypset një përkushtim më i madh dhe një vizion shumë më i qartë. Abedin Alija nga Forumi Rinor i LDD-së tha se subjekti ynë politik ka një vizion të qartë për ambientin dhe planifikimin hapësinor të



Projekti “Për një mjedis të pastër” i mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë